



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. 130 Prot

Datë 17 / 01 / 2022

Lenda: **Kthim përgjigje**

Drejtuar: **znj. Inva Hasanaliaj**

Adresa: Rr. 'Nasi Pavllo', Pall. 'Edil-Al', shk.1, kati 3, A-8, Tiranë1001, Shqipëri

Tel: +355 69 73 76 783

Email: invahasanaliaj@faktoje.al

Në bazë të kërkesës tuaj më datë 11/01/2022 me kerkues Inva Hasanaliaj objekti : Kërkesë për informacion ju bëjme me dije se:

Bashkia Përmet ashtu si në shumicën e vendit, mbetjet e zonave urbane mblidhen dhe transportohen nga vetë bashkia. Zonat rurale ende nuk mbulohen nga shërbime të menaxhimit të mbetjeve, mungojnë makina teknologjike, kosha mbeturinash, si rezultat popullsia gjen zgjidhje individuale të tilla si djegia, groposja ose hedhja jashtë vendeve të caktuara. Mbeturinat zakonisht digjen në vende të hapura, duke shkaktuar ndotje të madhe në zonat përreth. Metoda më e përdorur për trajtimin e mbetjeve është ajo e groposjes, megjithëse duhet përmendur dhe fakti që këto gropa nuk kanë një strukturë të mirë ose janë vendosur në zona të ndjeshme. Duhet theksuar se nuk ka impiante të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme dhe të djegies së mbetjeve urbane (të pa riciklueshme) si dhe mbetjeve industriale për shfrytëzimin e energjisë së tyre për industrinë prodhuese.

Për menaxhimin e mbetjeve në qytetin tonë veprohet si më poshtë:

1. Vlerat e buxhetit:

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
F0 17 Shpenzimet vjetore gjithësej për menaxhimin e mbetjeve (mblledhje, transport dhe trajtim mbetjesh)		7485	12,587	13,395	15,964	13281	17614	17577
F0 18 Shpenzimet vjetore për karburant për mblledhje dhe transport të mbetjeve		1523	1,570	2,200	2768	2330	2055	1845
F0 19 Shpenzime vjetore për pastrim, larje ose dezinfektim të kazanëve ose pikave të grumbullimit të mbetjeve								
F0 20 Shpenzimet vjetore për trajtimin e mbetjeve		842	125	200	200	252	0	0
F0 21 Shpenzime vjetore të tjera në rast vend depozitimi të paautorizuar			0	0	0			
F0 23 Shpenzimet vjetore për paga e sigurime për punëtorët në sektorin e menaxhimit të mbetjeve		4506	7,086	7,086	7,488	9025	13827	15320
F0 24 Shpenzimet vjetore administrative (materiale zyre, telefon, ujë) në sektorin e menaxhimit të mbetjeve		100	350	350	350	100	100	100
F0 25 Shpenzimet vjetore për qira në sektorin e menaxhimit të mbetjeve		0	0	0	0			
F0 26 Shpenzimet vjetore për amortizim të mjeteve të menaxhimit të mbetjeve	312	312	312	312	312	312	312	312
% vjetore e amortizimit	13.6	13.6	13.6	13.6	13.6			
Jeta e mbetur e kontejnerëve prej vitit 2018 (tejet te amortizuar)			-	-	-			
Jeta e mbetur e kamionëve prej vitit 2018 (tejet te amortizuar)			-	-	-			
F02 Shpenzimet vjetore për mirëmbajtjen e mjeteve të menaxhimit të mbetjeve		202	202	305	1000	1262	853	273
F02 Shpenzimet vjetore për sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve të menaxhimit të mbetjeve (nuk janë paguar, shume te vjetra)			0	0	50			0
F0 29 Shpenzimet vjetore kapitale në sektorin e menaxhimit të mbetjeve (blerje kontejner)			0	0	500		467	
F0 30 Shpenzimet vjetore për materiale pune në sektorin e menaxhimit të mbetjeve			100	100	200			
F0 31 Shpenzimet vjetore në rast nën-kontraktimi të shërbimit			-	-	-			
F0 32 Shpenzime vjetore në rast marrëdhënie PPP në sektorin e menaxhimit të mbetjeve			-	-	-			
F0 33 Shpenzime vjetore të tjera të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve			0	0	0	0		
Fitim / Humbjet (të gjitha të dhënat financiare në 000 lekë)	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
F0 34 Buxheti i planifikuar për menaxhimin e mbetjeve		7485	13,096	13,878	15,964			

F0 35 Buxheti i realizuar për menaxhimin e mbetjeve		7485	12,587	13,395	15964			
F0 36 Fitimi operativ			-	-	-			
F0 37 Fitimi pas taksës (TVSH)			-	-	-			
Burimi i fondit për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve								
F0 38 Burimi vjetor fondit për investime								
pjesa në % nga të ardhura të veta			-	-	100			
(nëse mundeni, specifikoni cila kategori e të ardhurave të veta)								
pjesa në % nga transfertat e pakushtëzuar			-	-	-			
pjesa në % nga grante nga donatorë			-	-	-			
F0 39 Burimi vjetor i fondit për shpenzime operative								
pjesa në % nga të ardhura të veta			70	70	70			
(nëse mundeni, specifikoni cila kategori e të ardhurave të veta)								
pjesa në % nga transfertat e pakushtëzuar			30	30	30			
Subvencionet/Grantet (të gjitha të dhënat në 000 Lekë)	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	
F0 40 Subvencionet nga buxheti i shtetit për vit			-	-	-			
F0 41 Grante nga donatorët për vit			-	-	-			
Sistemi i mblledhjes së tarifës								
F0 50 Si informoni klientët për detyrimin e tarifës së shërbimit?								

2. Menaxhimi bëhet nga vetë bashkia, nëpërmjet Brigadës së Pastrimit e përbëre si më poshtë :

- 2 makina me tonazh 5 ton dhe 10 ton
- 2 shoferë
- 5 punëtorë ngarkim shkarkimi
- 1 dezinfektues
- 1 brigadier
- 24 punëtorë nga të cilët: 14 punëtorë me fshesë për fshirjen e asfalteve dhe trotuareve, 8 punëtorë pastrues lagjesh e 2 punëtorë roje në fushën e grumbullimit të mbetjeve.

3. Mbetjet aktualisht po depozitohen në një pikë grumbullimi me sipërfaqe 3000 m² e quajtur Braçkovë. Vend-depozitimi i mbetjeve Braçkovë ndodhet në veri-perëndim të Bashkisë së Përmetit. Largësia nga qendra është rreth 5 km. Vend-depozitimi nuk ka një proces seleksionimi, mbeturinat pasi mbërijnë groposen. Vend-depozitimi ekzistues ku hidhen mbeturinat nuk është i izoluar dhe nuk ka masa mbrojtëse për të ndaluar ujërat nëntokësore nga depërtimi dhe rrjedhimisht çlirimi e kalimi i metaleve të rënda e ndotësve të tjerë.

4. Aktualisht Bashkia Permet ka vetëm një vend depozitimi të quajtur Brackove.

5. Zonat rurale ende nuk mbulohen nga shërbime të menaxhimit të mbetjeve, mungojnë makina teknologjike, kosha mbeturinash, si rezultat popullsia gjen zgjidhje individuale të tilla si djegia ose hedhja jashtë vendeve të caktuara. Shkaku kryesor mungesa e infrastruktures rrugore dhe teknologjike, largësia midis fashatrave të cilat çojnë në rritje të kostove të shërbimit.

6. Me buxhetin që kemi na duket e pamundur t'ja dalim financiarisht.

7. Ndodh që të këte djegie të mbeturinave nga persona të paidentifikuar megjithatë Bashkia ka marrë masa të menjehershme për neutralizimin dhe eliminimin e zjarreve gjithashtu jemi duke hapur aktualisht një vend depozitimi tjetër. Ne si bashki kemi në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Turizmit po punohet për ndërtimin e një venddepozitimi emergjent I cili shumë shpejt do të jetë aktiv dhe me parametra teknike bashkekohore.

8. Numri I koshave në Bashkinë Përmet

-220 kosha

9. Në kushtet që pasqyruam më sipër me buxhetin që kemi na duket e pamundur t'ja dalim financiarisht për plotësimin e të gjitha problematikave për mbetjet.

**KRYETARI BASHKISE
ALMA HOXHA**

